



Deklaratë për shtyp – 555/07/2020

**Republika lançon „NRW Überbrückungshilfe Plus“ dhe siguron ekzistencën e të
vetëpunësuarve të vetëm, punonjësve të pavarur
dhe bizneseve të vogla**

08.07.2020
Faqja 1 nga 3
Zyra për shtyp e kancelarisë së shtetit
40213 Düsseldorf

Telefon 0211 837-1134
0211 837-1405
ose 0211 837-1151

presse@stk.nrw.de
www.land.nrw

Ministri Pinkwart: Aplikimi është i thjeshtë, joburokratik dhe i sigurt, në mënyrë që bizneset t'ia dalin me sukses në muajt në vazhdim

Ministria e Ekonomisë, Inovacionit, Dixhitalizimit dhe Energjisë ju komunikon:

Qeveria federale dhe republika e Nordrhein-Westfalen po lançojnë një nismë ndihme të përkohshme në mënyrë që të mundësojnë mbështetje të mëtejshme për bizneset e vogla dhe të mesme, të cilat janë afektuar shumë nga pandemia. Sipërmarrësit dhe sipërmarrëset të cilët përmbushin kushtet janë ata të cilët kanë patur fitime biznesi 60 përqind më të ulëta se një vit më parë, gjatë muajve Prill dhe Maj 2020. Ata marrin subvencione jo të ripagueshme për muajt Qershor deri në Gusht për të kompensuar për shitjet e humbura dhe për të mbuluar kostot fikse të veprimtarisë. Republika e suplementon ndihmën federale me një program shtesë për pagën sipërmarrëse: Nëpërmjet "NRW Überbrückungshilfe Plus", individët e vetëpunësuar dhe punonjësit e pavarur do të marrin një pagesë të vetme prej 1000 euro në muaj për maksimumi tre muaj. Qeveria e Republikës ka përlogaritur 100.000 aplikantë për programin shtesë dhe ka vendosur në dispozicion 300 milionë euro për këtë qëllim.

Ministri i Ekonomisë Prof. Dr. Andreas Pinkwart: „Është diçka e mirë që u lançua ndihma e përkohshme e qeverisë federale dhe republikës . Qeveria e republikës dëshiron të bëjë më shumë se sa është përcaktuar tek programi i qeverisë federale për të vetëpunësuarit e vetëm, punonjësit e pavarur dhe bizneset e vogla të cilat janë afektuar nga kriza në Nordrhein-Westfalen. Për këtë arsye ne po e suplementojmë

ndihmën me programin tonë shtesë të financuar nga fondet e republikës, në mënyrë që bizneset t'ia dalin me sukses në muajt në vazhdim. Proçesi i aplikimit është i thjeshtë, joburokratik dhe totalisht dixhital, në mënyrë që ndihma të mbërrijë shpejt. Aplikimet për ndihmën e përkohshme dhe programin shtesë „NRW Überbrückungshilfe Plus“ dorëzohen nga një këshilltar taksash, auditues ose nga një llogaritar i betuar, të përcaktuar nga aplikanti.

Qeveria e republikës ka vendosur në dispozicion një portal aplikimi kombëtar uniform për këtë qëllim. Këshilltarët mund të regjistrohen aty dhe të dorëzojnë aplikimin duke filluar nga 10 Korriku 2020.

Informacionet në lidhje me programin i gjeni tek:

www.wirtschaft.nrw/ueberbrueckungshilfe.

Gjatë krizës qeveria federale dhe republika krijuan një rrjet të gjerë mbështetje të likuiditetit:

Garanci deri në 2.5 milionë euro: Bürgschaftsbank NRW mund të garantojë deri në 90 përqind të një kredie bankare. Me ndihmën e Express-Bürgschaft bizneset mund të marrin shuma premtuese deri në 250.000 euro brenda 72 orëve. Duke filluar nga Qershori ekziston dhe SchnellBürgschaft 100 e cila i ndihmon kompanitë të cilat kanë deri në 10 punonjës të sigurojnë 100 përqind kolateral për borxhe deri në 250.000 Euro. Që prej fillimit të vitit, Bürgschaftsbank i është përgjigjur pozitivisht 400 aplikimeve të garancive dhe marrëveshjeve të sigurisë, duke siguruar kështu 5000 vende pune.

Garancitë duke nisur nga 2.5 milionë euro : Bizneset e mesme të cilat janë më të mëdha mund të dorëzojnë aplikimet për një garanci shteti. Kreditë kapitale të veprimtarisë të varura nga koronavirusi, mund të garantohen me deri në 90 përqind. Që nga shpërthimi i pandemisë së koronavirusit, republika ka lëshuar zotime për 28 garanci shteti me një sasi prej rreth 470 milionë euro.

Kompensimi i punonjësve me orë pune të shkurtuara: Asnjë instrument mbështetje nga shteti nuk është më i rëndësishëm se ky gjatë krizës: Edhe pse kufizimi i lëvizjes është hequr, qindra mijëra individë janë ende duke punuar me orë pune të shkurtuara. Në këtë

mënyrë, kur situata të përmirësohet sërish, - shenjat e para janë të dukshme-, bizneset mund të rikthehen përsëri tek një fuqi punëtore e garantuar.

Ndihma për bizneset startup nga NRW.BANK, Start-up Akut: Kriza e koronavirusit është një sfidë shumë e madhe, veçanërisht për kompanitë e reja. Programi i ri i mbështetjes NRW.Start-up akut i ndihmon ata : Kredi të konvertueshme me vlerë deri në 200.000 euro të cilat forcojnë kapitalin fillestar.

Ndihma për koronavirusin e KfW: Bizneset e NRW kanë marrë deri tani më shumë se 17.000 kredi të KfW nga programi i koronavirusit. Atyre u është vendosur në dispozicion një shumë dëmshpërblimi deri në 100 përqind në mënyrë që bankat mund t'u mundësojnë shpejt bizneseve likuiditet.

Nëse keni pyetje, ju lutemi kontaktoni zyrën e shtypit të Ministrisë së Ekonomisë, Inovacionit, Dixhitalizimit dhe Energjisë, Telefon 0211 61772-204 (Matthias Kietzmann).

Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion në internet në adresën e internetit të qeverisë së Republikës www.land.nrw